



## Forumi i Gjashtë Kombëtar i Grave Shqiptare Frankofone

“Inovacioni dhe teknologjia për fuqizimin e gruas - Figura e gruas në rrjetet sociale”

7 Mars 2023, ora 09:30

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë



Në kuadër të « Pranverës së Frankofonisë në Shqipëri », Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës, Universitetin e Shkodrës, Ambasadën Franceze në Shqipëri, Agjencinë Universitare të Frankofonisë, me nismën e Rrjetit të Grave Frankofone, organizon edicionin e VI të Forumit të Grave Shqiptare Frankofone me temë **“Inovacioni dhe teknologjia për fuqizimin e gruas - Figura e gruas në rrjetet sociale”**.

Një qasje e përgjegjshme gjinore ndaj inovacionit, teknologjisë dhe edukimit digjital mund të rrisë ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave për të drejtat e tyre dhe angazhimin qytetar. Përparimet në teknologjitë digjitale ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për një zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Pjesëmarrja e grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara në sektorin e teknologjisë rezulton një zgjidhje më kreative dhe ofron potencial më të madh për inovacione që plotësojnë nevojat e grave, promovojnë barazinë gjinore si edhe rrisin mirëqenien e shoqërisë.

Për fuqizimin e grave është e rëndësishme të forcohen aftësitë digjitale dhe aksesit i tyre në teknologji. Prandaj, nevoja për teknologji gjithëpërfshirëse dhe transformuese dhe edukim digjital është thelbësor për një të ardhme më të mirë shoqërore.

Ky forum synon të promovojë kontributin e grave që punojnë për zhvillimin e teknologjive transformuese dhe edukimin digjital. Takimi për ditën ndërkombëtare të gruas do të theksojë gjithashtu nevojën për të mbrojtur të drejtat e grave dhe vajzave në hapësirat digjitale dhe për të trajtuar dhunën me bazë gjinore në internet lehtësisht e favorizuar nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit.

## **Programi**

**09:30 – 10:00 Hapja e Forumit të 6-të Kombëtar të grave shqiptare frankofone**

### **Fjala e hapjes :**

Znj. Esmeralda KROMIDHA – Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Z. Roland ZISI – Rektor i Universitetit të Vlorës

Znj. Ana PETANI – Këshilltare e Ministres së Shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes

Z. Mohamed KETATA – Drejtor rajonal i Agjensisë Universitare Frankofone për Europën Qëndrore dhe Lindore (në linjë)

### **Paneli I**

**10:00 – 11:15 “Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në fuqizimin e gruas në profesion dhe në sipërmarrje.”**

**Moderatore Znj. Drita Rira (Pedagoge Universiteti i Tiranës)**

### **Diskutime nga:**

10:00 - Znj. Valentina DUKA – Pedagoge në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës: *“Gruaja, humanitetet dhe inovacioni.”*

10:10 - Znj. Majlinda KETA, Znj. Odeta KROMIÇI – Pedagoge në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës:

*“Profili gjinor i sfidës me teknologjinë, inovacionin dhe etikën digjitale në UT-ës. Rezultatet e para të një studimi.”*

10:20 - Znj. Linda SHOMO – Themeluese dhe CEO e kompanisë “EasyPay”:

*“Krijimi i sipërmarrjes nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit dhe sfidat e kësaj sipërmarrjeje për një grup.”*

10:30 - Znj. Alda BARDHYLI - Drejtore e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit:

*“Ndikimi i lëvizjeve feministe franceze në letrat shqipe.”*

10:40 - Znj. Albana MUCAJ – Themeluese dhe drejtuese e Qendrës Multifunkionale për fëmijë

*“Kallz”: “Women Startup Competition.”*

10:50 - Znj. Etleva DOMI - Nëndrejto e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë: *“Zhvillimet teknologjike dhe aftësimi në media dhe informacion: Sfida e bibliotekave sot.”*

11:00 - Znj. Esmeralda KROMIDHA, Znj. Drita RIRA, Znj. Ogerta KORUTI – Universiteti i Tiranës:

*“Ndikimi i teknologjisë në zhvillimin profesional të gruas dhe portretizimi i gruas në media. Rast studimor.”*

**Pushim kafe 11:10 – 11:30**

## **Paneli II**

**11:30 – 12:30 “Portretizimi i gruas shqiptare në rrjetet sociale”**

**Moderatore Znj. Ogerta Koruti (Pedagoge Universiteti i Tiranës)**

**Diskutime nga:**

11:30 - Znj. Edlira ÇEPANI – Koordinatore kombëtare e rrjetit "Barazia në Vendimmarrje":

*“Teknologjia, zëri i grave në vendimmarrje.”*

11:40 - Znj. Adriana GJIKA – Pedagoge në Universitetit Teknologjik “Ismail Qemali”, Vlorë:  
*“Gruaja dhe teknologjia.”*

11:50 - Znj. Elsa Skënderi RAKIPLLARI – Zv. Dekane në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë,  
Universiteti i Tiranës: *“Diskursi për gratë në rrjetet sociale.”*

12:00 - Znj. Dhurata HOXHA, Znj. Drita BRAHIMI – Pedagoge në Universitetin “Luigj  
Gurakuqi”, Shkodër: *“Formimi i vazhduar i mësuesve të gjuhës frënge përballë përparimeve të  
teknologjisë digjitale.”*

12:10 - Znj. Armela PANAJOTI – Dekane e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Universiteti i  
Vlorës: *“Performanca digjitale shoqërore dhe formësimet e modeleve gjinore në teknologji dhe  
inovacion.”*

12:20 - Znj. Stelina NDREU – Kryetare e Këshillit studentor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja:  
*“Ndikimi i rrjeteve sociale te vajzat e reja dhe zhvillimi i tyre profesional.”*

**12:30 – 12:45 Pyetje dhe debat**